

Pozicion i hapur pune Senior Accountant (Kontabilist/e i/e lartë)

Një ftesë për ata që duan të ndërtojnë, jo thjesht të punojnë

Në AlProfit Consult ne besojmë se kontabiliteti nuk është një profesion teknik i ftohtë, por një profesion me ndikim real në jetën e njerëzve dhe në vendimet që marrin bizneset çdo ditë. Ne nuk ekzistojmë vetëm për të përgatitur pasqyra financiare apo për të përmbushur detyrime ligjore. Ne ekzistojmë për të ndihmuar bizneset të kursejnë kohë dhe para, duke u dhënë qartësi, strukturë dhe besim.

Puna jonë ka kuptim sepse ndikon direkt në jetën e përditshme të klientëve tanë. Dhe pikërisht për këtë arsye, njerëzit që punojnë me ne kanë rëndësi më shumë se çdo proces apo program.

Rreth rolit

Pozicioni i Senior Accountant në AlProfit nuk është një rol i izoluar dhe as një punë rutinë e mbyllur pas një tavoline. Është një rol aktiv, në zemër të shërbimit ndaj klientit dhe në bashkëpunim të vazhdueshëm me ekipin.

Si Senior Accountant, ju do të menaxhoni në mënyrë të pavarur një portofol klientësh, nga çështjet e përditshme kontabël dhe tatimore te përgatitja e pasqyrave financiare dhe raporteve periodike, duke qenë pika kryesore e kontaktit për ta. Por mbi të gjitha, do të kuptoni biznesin përtej dokumenteve dhe shifrave dhe do të shihni se si puna juaj ndikon drejtpërdrejt në vendimmarrjen e tyre.

Ky është një rol për dikë me eksperiencë pune në kontabilitet, që kërkon pavarësi, gjykim profesional dhe përgjegjësi më të madhe në punën e përditshme. Aftësitë teknike janë të domosdoshme, por qëndrimi, përgjegjësia dhe mënyra e të menduarit janë ato që e bëjnë vërtet ndryshimin në një rol të tillë.

Përgjegjësitë kryesore të rolit

- Menaxhimi i pavarur i një portofoli klientësh, duke mbuluar të gjithë ciklin kontabël dhe tatimor.
- Rishikimi dhe verifikimi i regjistrimeve kontabël, faturave dhe deklarimeve, duke garantuar saktësinë para dorëzimit.
- Përgatitja dhe analiza e pasqyrave financiare dhe raporteve periodike për klientët.

- Trajtimi i çështjeve më komplekse kontabël dhe tatimore, si dhe këshillimi i klientëve për detyrimet dhe afatet e tyre.
- Zbatimi i axhendës së punës dhe ndjekja e çështjeve në vazhdim.
- Organizimi dhe drejtimi i takimeve periodike me klientët, zakonisht çdo tre ose gjashtë muaj.
- Mbështetja dhe orientimi i kolegëve më të rinj në ekip, duke ndarë njohuri dhe përvojë.
- Zbatimi dhe përmirësimi i procedurave të brendshme, si dhe dokumentimi korrekt i punës së kryer.

Kë kërkojmë?

Ne nuk kërkojmë njerëz që dinë gjithçka. Kërkojmë njerëz që duan të bëhen më të mirë.

Kërkojmë kandidatë me eksperiencë pune në kontabilitet, që kanë përfunduar studime në Financë dhe Kontabilitet ose në fusha të tjera të lidhura ngushtë me biznesin dhe menaxhimin. Përtej titullit të diplomës, për ne ka rëndësi mënyra si mendoni, si komunikoni dhe si i qaseni punës.

Ajo që ne vlerësojmë realisht është aftësia për të punuar në grup, dëshira për të mësuar vazhdimisht, përgjegjësia për punën e marrë përsipër dhe thjeshtësia në komunikim. Ne besojmë se puna e mirë bëhet kur njerëzit ndihmojnë njëri-tjetrin, planifikojnë përpara dhe nuk fshihen pas justifikimeve.

Njohja e gjuhës angleze dhe/ose italiane përbën një avantazh shumë të madh, jo vetëm për komunikimin me klientë, por edhe për zhvillimin profesional afatgjatë brenda kompanisë.

Si është të punosh në AlProfit

Në AlProfit puna bëhet në ekip dhe me plan. Ne nuk besojmë në improvizim të vazhdueshëm dhe as në zgjidhje momentale që krijojnë probleme më vonë. Preferojmë më pak punë, por të menduara dhe të kryera siç duhet.

Do të gjeni një ambient ku komunikimi është i hapur, ku pyetjet nuk paragjykojnë dhe ku gabimet trajtohen si mundësi për të mësuar, jo si arsye për të fajësuar. Secili ka përgjegjësitë e veta, por askush nuk lihet vetëm përballë tyre.

Objektivi ynë është të ndërtojmë një ekip të qëndrueshëm, ku njerëzit rriten profesionalisht dhe personalisht, dhe ku puna e përditshme ka kuptim dhe drejtim.

Pse kjo ftesë

Ne po kërkojmë më të mirët, jo në kuptimin e njerëzve perfektë, por në kuptimin e njerëzve të duhur, në vendin e duhur. Njerëz që duan të kontribuojnë, të mësojnë dhe të ndërtojnë diçka afatgjatë.

Nëse po kërkonit thjesht një vend pune, ndoshta ka shumë alternativa të tjera. Nëse po kërkonit një ambient ku mund të rriteni, të sfidoheni dhe të bëheni pjesë e një ideje më të madhe, atëherë kjo ftesë është për ju.

Procesi i aplikimit

Aplikimet dërgohen në adresën alprofit@alprofitconsult.al

Procesi përfshin një intervistë të parë me një test të shkurtër teorik dhe praktik, si dhe një intervistë finale me kandidatët më të përshtatshëm. Qëllimi ynë nuk është vetëm të vlerësojmë kandidatin, por të kuptojmë nëse ekziston përputhje reale nga të dyja palët.